



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË
BORDI

VENDIM

Nr. 293, Datë 26.12.2024

MBI

**KËRKESËN E SHOQËRISË “HYDROBORSH” SH.P.K. PËR DHËNIEN E
AUTORIZIMIT NGA ERE PËR NDRYSHIMIN E ORTAKUT QË KONTROLLON
INTERESAT E SAJ**

Në mbështetje të nenit 16 të ligjit nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar; neneve 5, 7, 9, pika dhe 5, dhe nenit 10, të Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien e autorizimit nga ERE për ndryshimin e statusit ligjor të të licencuarit, ndryshimin e ortakut/aksionarit që kontrollon interesat e të licencuarit dhe vendosjen e kuotave/aksioneve të ortakut/aksionerit që kontrollon interesat e të licencuarit si mjete për garantimin e përmbushjes së detyrimit/eve ndaj të tretëve, miratuar me vendimin e bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 235, datë 26.11.2021; si dhe nenit 15 të Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s, miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.06.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 26.12.2024, mbasi shqyrtoi relacionin nr. 770/24 prot., datë 23.12.2024, të Drejtorisë së Licencimit dhe Autorizimeve, “Mbi kërkesën e shoqërisë “HYDROBORSH” sh.p.k. për dhënien e autorizimit nga ERE për ndryshimin e ortakut që kontrollon interesat e saj”,

Konstatoi se:

- Shoqëria “HYDROBORSH” sh.p.k. është licencuar në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga hidrocentralet “Fterra” dhe “Fterra 1” me vendimin e bordit të ERE-s nr. 67, datë 06.06.2012.
- Me shkresën protokolluar në ERE me nr. 770/15 prot., datë 15.07.2024, shoqëria ka paraqitur kërkesën dhe dokumentacionin për marrjen e autorizimit nga ERE për ndryshimin e ortakut që kontrollon interesat e saj.
- Në vijim, me shkresën e saj të datës 30.08.2024, të protokolluar në ERE me nr. 770/17 prot., datë 03.09.2024, shoqëria ka depozituar dokumentacion nga shqyrtimi i të cilit ka rezultuar se ka nevojë për depozitim informacioni/dokumentacioni shtesë, ndaj ERE iu drejtua sërish shoqërisë me shkresën me nr. 770/18 prot. datë 23.10.2024.

- Me shkresën nr. 770/20 datë 02.12.2024, ERE vlerësoi të arsyeshme mbajtjen e një seance dëgjimore në datën 12.12.2024. Në seancën e mbajtur shoqëria ka pretenduar se nuk e ka disponuar shkresën e fundit e cila ju rivendos në dispozicion edhe gjatë seancës.
- Në vijim me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 770/22 prot., datë 20.12.2024, shoqëria ka depozituar informacionin dhe dokumentacionin e munguar.
- Pas analizimit të kërkesës dhe dokumentacionit të përcjellë nga shoqëria me korrespondencën vijuese të realizuar me ERE-n, rezulton se ajo ka plotësuar tërësisht dokumentacionin e kërkuar në nenin 7, të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien e autorizimit nga ERE për ndryshimin e statusit ligjor të të licencuarit, ndryshimin e ortakut/aksionarit që kontrollon interesat e të licencuarit dhe vendosjen e kuotave/aksioneve të ortakut/aksionarit që kontrollon interesat e të licencuarit si mjete për garantimin e përmbushjes së detyrimit/eve ndaj të tretëve”, miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 235, datë 26.11.2021.
- Shoqëria “HYDROBORSH” sh.p.k., nuk ka detyrime të pashlyera ndaj ERE-s për sa i përket pagesave të rregullimit.
- Dhënia e autorizimit nga ERE për ndryshimin e ortakut që kontrollon interesat e shoqërisë “HYDROBORSH” sh.p.k. nuk e çliron këtë të fundit nga detyrimi për të marrë autorizimin/miratimin e organeve të tjera apo palëve të treta për këtë ndryshim, në rast se kjo kërkohet nga këto organe.

Për gjithë sa më sipër, bordi i ERE-s,

Vendosi:

1. Dhënien e autorizimit nga ERE për ndryshimin e ortakut që kontrollon interesat e shoqërisë “HYDROBORSH” sh.p.k.
2. Ortaku i vetëm që kontrollon interesat e shoqërisë “HYDROBORSH” sh.p.k. bëhet shoqëria “BRUÇI” sh.p.k.
3. Dhënia e autorizimit nga ERE për ndryshimin e ortakut që kontrollon interesat e shoqërisë “HYDROBORSH” sh.p.k. nuk e çliron këtë të fundit nga detyrimi për të marrë autorizimin/miratimin e organeve të tjera apo palëve të treta për këtë ndryshim, në rast se kjo kërkohet nga këto organe.
4. Shoqëria duhet të depozitojë në ERE ekstraktin historik të regjistrit tregtar brenda 10 (dhjetë) ditëve nga reflektimi në të i ndryshimit të ortakut që kontrollon interesat e saj.

5. Ky vendim është objekt rishikimi nga ERE.
6. Drejtoria e Licencimit dhe Autorizimeve, të njoftojë shoqërinë “HYDROBORSH” sh.p.k. dhe Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë për vendimin e bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t’i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes së vendimit, rishikimin e vendimit të bordit në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI

Petrit AHMETI